




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.rks-gov.net/gjilan, tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

Në bazë të nenit 14., 16, 17, 20, 22 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapsinor, nr. 2003/14, nenit 38.1.2 dhe Ligjit për Ndryshimet e Ligjit për Planifikim Hapësinor.nr. 03/L-106, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor mbi Elementet e Themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1.2. të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në vështrim të pikës V. të Vendimit mbi miratimin e PRrU: Qendra/z-1", nr. 01-5791, të dt. 19.05/2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 06.04.2012, miraton këtë:

V E N D I M

Për miartimin e Propozim Zgjidhjes Urbanistike të Kompleksit: " Shkollat e Mesme" në Gjilan

Neni 1.

Me këtë vendim miratohet Propozimi Zgjidhja Urbanistike për oragnizimin hapësirës dhe ndërtimin e ndërtesave Edukativo – Arsimore dhe objekteve tjera përcjelëse, objekteve dhe përmbajtjeve tjera të infrastrukturës komunale: rrugëve komunikuese, shtigjeve për këmbësor, hapësirave gjelbëruese etj., brenda kompleksit të Shkollave të Mesme në Gjilan.

Neni 2.

Kompleksi nga pika 1. e këtij Vendimi, përfshinë, hapësirën brenda kufinjëve duke filluar nga rruga "Zija Shemsiu", para Shkollës së Mesme Teknike "Memet Isai", duke vazhduar përgjatë rrugës deri të udhëkryqi mbi Fakultetin e Edukimit (duke përjashtuar pronat Private përbri SHMT dhe Gjinezit), ku kthehet në të majtë duke përcjellë rrugën "Haqif Tetova" deri të objekti i vogël i PTK-së, ku kthehet në të majtë deri te kufiri i truallit të ndërtesës së banimit kolektiv, kthehet në të majtë duke përcjellë kufirin e trojeve deri te rruga përbri Ndërtesës së Inkubatorit të Biznesit, kthehet në të majtë duke përcjellë rrugën deri te hyrja kryesore në Stadion të Qytetit e duke vazhduar përgjatë kufirit të tribinave deri te kufiri i pronave private ku kthehet në të majtë duke përcjellë kufirin në mes pronave private (të cilat pjesërisht do të përfshihen) dhe pronës komunale deri te pika fillestare në rrugën " Zija Shemsiu", në sipërfaqe prej gjithësej:5.93.68 ha, në tërsi sipas paraqitjes grafike e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Neni.3.

Propozim Zgjidhja Urbanistike nga pika 1. e këtij Vendimi, është hartuar nga Sektori për Planifikim i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilani dhe e njëta nënkupton caktimin e kushteve të lokacionit për ndërtimin e ndërtesave dhe objekteve tjera nga pika 1. e këtij Vendimi.

Neni.4.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit kushtet e lokacionit nga propozim zgjidhja Urbanistike ta inkorporojë në Planin Rregullues Urban: "Qendra /z-1 ".

Neni.5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjoedezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan.

Neni.6.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Neni.7.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Plani Detaj Urbanistik dhe aktet tjera që burojnë nga ai Plan, për hapësirën e përfshirë në pikën 2. të këtij Vendimi.

01.Nr. 16-38244
Gjilan, më: 06.04.2012.

Kuvendi i komunës,
Izmi Zeka, Kryesues